

# FAKULTETI I MJEKËSISË

## Fizioterapi & Infermeristikë

Partneri Akademik në këtë proces është Universiteti i Romës "Tor Vergata". Degët janë konceptuar si binjake të homologeve që zhvillohen në Universitetin e Romës. Ky partneritet bën të mundur lëshimin e një **Diplome të përbashkët** të Universitetit Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë" dhe Universitetit "Tor Vergata" i Romës, i vlefshëm në Itali e në vendet e BE-së.

Dy Programet e Studimit kanë një kohëzgjatje prej 3 vitesh akademike, që ndahen në gjashtë semestra studimi dhe që parashikojnë marrjen e 180 krediteve universitare (ECTS). Frekuentimi i mësimit dhe i praktikave klinike është i detyrueshëm në masën 75% për çdo lëndë dhe në të gjitha vitet. Mësimdhënia zhvillohet kryesisht në italisht nga profesorë të Universitetit të Romës dhe nga profesorë shqiptarë.


Në vitin e parë, studenti i Fizioterapisë kryen praktikë klinike pranë spitaleve publike, pranë Qendrës së Mjekësisë Sportive dhe Rehabilitimit të Kompleksit tonë spitalor-universitar, ose pranë shërbimeve rehabilituese spitalore, në palestra, etj. Studenti i Infermierisë zhvillon aktivitete të profesionalizuara duke praktikuar teknika simulimi mbi manekinë dhe duke shtrëtëzuar shërbime të tjera didaktike dhe shërbime spitalore.

Provimi përfundimtar, që ka vlerën e provimit të shtetit për ushtrimin e profesionit të fizioterapistit ose të infermierit, zhvillohet në dy faza:

- prova praktike, gjatë së cilës studenti do të tregojë që ka përvetësuar të gjitha njohuritë dhe aftësi te teoriko-praktike dhe tekniko-operative të profesionit;
- mbrojtja e një teme diplome.

Universiteti është një strehëz familjare që ofron:

- Kushte bashkëkohore dhe mikpritëse të një ndërtese e ideuar si një shtëpi e madhe ndërkombëtare, me studentë nga Shqipëria, nga Italia dhe nga vende të ndryshme të BE-së.
- Një hapësirë të lirë dhe të gjelbëruar, konceptuar si mjedis për t'u çlodhur dhe për të kaluar kohën e lirë.
- Një bibliotekë të pasur dhe të përditësuar në të gjitha fushat e: Mjekësisë, Infermierisë, Fizioterapisë, Farmacisë, Ekonomisë dhe Shkencave Politike, Inxhinierisë dhe Arkitekturës, e cila u ofrohet lexuesve të saj në gjuhë të ndryshme: shqip, italisht, anglisht, gjermanisht, spanjisht etj.
- Një mensë, të realizuar sipas ndërtimeve të standartit europian, si një shërbim i ri që i lejon studentët të jenë pjesëmarrës në jetën e kampusit gjatë gjithë harkut kohor ditor.




**ADRESA:** Kompleksi Spitalor Universitar "Zoja e Këshillit të Mirë" Rr. Dritan Hoxha, Tiranë, Shqipëri

e-mail: info@unizkm.edu.al  
Web: www.unizkm.al  
Tel. : 00355 4 2273290



UNIVERSITETI KATOLIK  
"ZOJA E KËSHILLIT TË MIRË"



UNIVERSITETI I ROMËS  
"TOR VERGATA"

UNIVERSITETI KATOLIK  
"ZOJA E KËSHILLIT TË MIRË"

FAKULTETI I MJEKËSISË

Fizioterapi  
&  
Infermeristikë

Diplomë e përbashkët  
me Universitetin e Romës

## FIZIOTERAPI

Fizioterapia është një profesion shëndetësor që trajton zhvillimin, mbajtjen dhe përmirësimin e lëvizjes gjatë gjithë jetës, veçanërisht në pacientët që kanë pësuar trauma e sëmundje të ndryshme, ose tek njerëzit e moshave të thyera. Kështu që ajo përmirëson cilësinë e jetës nëpërmjet parandalimit, trajtimit, aftësimin dhe rehabilitimit të pacientëve në shumë specialitete: ortopedi, neurologji, reumatologji, gjinekologji, kardiologji, pneumatologji, pediatri, etj.

### Profili Profesional

Fizioterapisti është profesionisti që zhvillon në autonomi ose në bashkëpunim me specialistët e tjerë ndërhyrje parandalimi, kurimi dhe rehabilitimi ndaj pacientëve në fushat e lëvizjes, të funksioneve kortikale të sipërme dhe të organeve të dëmtuara. Në varësi të diagnozave dhe rekomandimeve mjekësore, ai përcakton programin e rehabilitimit, praktikon në mënyrë të pavarur aktivitete terapeutike për riedu-



kimin funksional të paaftësive motorike, psikomotorike dhe konjitive duke përdorur terapi fizike, manuale, mazoterapike, propozon vendosjen e protezave dhe mjeteve ndihmëse, stërvit pacientin në përdorimin e saj dhe verifikon efektshmërinë. Gjithashtu fizioterapisti mund të kryejë edhe aktivitete studimi, mësimdhënieje, konsulenca profesionale dhe mund të specializohet në fusha të ndryshme duke frekuentuar master profesional ose shkencor.

I diplomuari në Fizioterapi mund të punojë në struktura sanitare, publike ose private, si nëpunës ose si profesionist i lirë.

## INFERMIERISTIKË

Infermieristika është një disiplinë e Mjekësisë, që trajton dhënien e ndihmës mjekësore ndaj të sëmurëve, kurimin e tyre dhe përkujdesjen ndaj individëve për të mbajtur dhe përmirësuar gjendjen e tyre shëndetësore. Për këtë arsye është një profesion me vlerë të lartë shoqërore, që e vendos Infermierin në një marrëdhënie të ngushtë me të sëmurin, familjen dhe kontekstin e tij social.

### Profili Profesional

Infermieri është profesionisti që merret me asistencën infermieristike, kuruese, qetësuese dhe rehabilituese, të natyrës teknike dhe edukative. Ai merr pjesë në përcaktimin e nevojave shëndetësore, planifikon, administron dhe vlerëson ndërhyrjen asistencialë, garanton zbatimin e saktë të udhëzimeve mjekësore diagnostikuese dhe kuruese. Në veçanti, promovon dhe përhap kulturën e shëndetit në shoqëri, projekton dhe realizon, në bashkëpunim me profesionistë



të tjerë ndërhyrje formuese dhe edukuese për personin dhe familjen e tij; identifikon nevojat e asistencës infermieristike të personit dhe të familjes së tij; planifikon, menaxhon dhe vlerëson ndërhyrjen infermieristike dhe asistencialë, garanton zbatimin e rregullt të recetës. Infermieri ndihmon në kërkimin shkencor, në formimin universitar të personelit ndihmës, dhe pas diplomimit mund të specializohet në fusha të ndryshme duke frekuentuar master profesional ose shkencor. I diplomuari në Infermieristikë mund të punojë në struktura sanitare, publike ose private.

### Master

Universiteti Katolik ZKM ofron:

për të diplomuarit në **Fizioterapi**:

- *Master Shkencor* "Shkencat Rehabilituese të Profesioneve Shëndetësore"
- *Master Profesional* "Menaxhim për Funksionet e Koordinimit"

për të diplomuarit në **Infermieristikë**:

- *Master Shkencor* "Shkencat Infermieristike dhe Obstetrike"